

Kompania Rajonale e Ujësjetës
SH.A.

HIDRODRINI

Zyret Qëndrore – Zyra për Media
rr. 'Lekë Dukagjini' Nr, 156 / 30000 Pejë
email: zip@hidrodrini.com
telefoni: 039 / 432 355
www.hidrodrini.com

KRU 'HIDRODRINI' Sh.A.-Pejë
Menaxhmenti Rajonal

DEMANT ndaj deklarimeve të përfaqësuesve të fshatit Gorazhdec, në raport me faturat e ujit dhe elementet tjerë që kanë të bëjnë me KRU 'Hidrodrini' Sh.A., në emisionin 'Jeta në Kosovë', transmetuar në RTV 'Dukagjini', të Premtën më 14 Qershor 2024, me titull: Problemet e qytetarëve të Gorazhdecit.

1.

Faturat për konsumatorët e tërë zonës së Mbulueshmërisë, (me të dhënat kryesore) shpërndahen në tre gjuhë: Shqip, Serbisht dhe Anglisht! Kjo është normë dhe praktikë, lehtë e verifikueshme. Rasti konkret, përpos në emisionin në fjalë, ka pasur tendencë të politizohet edhe në vizitën e Ambasadorit Eskobar në këtë fshat, për çfarë, Kryeshefi Ekzekutiv ing. Dri Cena, ka pritur në takim sqarues më pas edhe përfaqësues të lartë të Ambasadës Amerikane në Kosovë, OSBE-së si dhe përfaqësuesit e komunitetit serb së bashku me ata të Komunës së Pejës për disa herë. Krahas faturave, edhe Thirrjet dhe Apelet e kompanisë, për konsumatorët, janë ndarë në dy gjuhësi, Shqip dhe serbisht, në zonat ku jeton pakica serbe.

2.

KRU 'Hidrodrini' Sh.A. nuk ka ndarë faturat me borxhe të akumuluar 25 vjeçare për konsumatorët e Gorazhdecit, meqë kjo informatë është e paqëndrueshme, sepse nuk ekzistojnë borxhe me qark kohor të tillë. Në rastin konkret, me Gorazhdecin, KRU 'Hidrodrini' Sh.A. ka ndarë fatura me borxhe të akumuluar më së shumti, për 32 muaj, kjo për shkak të qasjes së inkasantit në periudhën pandemike, më pas pensionimin e të njejtit, nga Marsi 2021, dhe kjo ka ndodhur deri në tetor 2023, kur me Konkurs të rregullt, me inkurajimin e menaxhmentit dhe personalisht Kryeshefit Ekzekutiv ing. Dri Cena, është pranuar në punë inkasanti i ri, nga komuniteti serb, për këtë zonë.

3.

Në fshatin Gorazhdec, janë 250 ujëmatës të instaluar, prej tyre 105, (ekonomi familjare) borxhlinjë, që kanë kaluar tek procedurat e përmbaruesit, 145 të tjerë që kanë shprehur interesim për shlyerje të borxheve. Për këto çështje, gjatë vizitës së Kryeshefit Ekzekutiv Cena në terren dhe takimeve me përfaqësuesit e komunitetit, konsumatorëve që kanë kaluar tek përmbaruesi u është sqaruar se të njejtit duhet vazhduar me procedurat përmbarimore, ndërsa pjesës tjetër u është ofruar mundësia për Marrëveshje Ri-programimi të borxhit, me Kompaninë, (prej 3 deri në 5 vite). Për ti ndihmuar çështjes, që mos të kalojë në terrenin politik, bëjmë me dije, se fshati Gorazhdec ka konsumatorë të nacionalitetit të perzier, shqiptarë, serb dhe pakica tjera.

Për të qenë korrekt dhe transparent, ri-kujtojmë së në kuadër të zonës tonë të mbulueshmërisë, në hartën e shërbimeve kemi edhe fshatra të tjerë me komunitet qoftë serb, qoftë të perzier dhe se me të njejtit, asnjëherë, nuk është paraqitur asnjë problematikë në bashkëpunim.

KRU 'Hidrodrini' mbetet i përkushtuar që të ofrojë shërbime 24 orë, në 7 ditë të javës, me shtrirje të barabartë të të gjitha shërbimeve në tërë zonën e mbulueshmërisë.

Me këtë rast, kujtojmë se jemi në periudhën e rënies së sasisë në burime dhe ngritjes së temperaturave, andaj, kjo detyron që kompania të filloi me orare të reduktiveve për tërë zonën, komunat Pejë, Klinë, Istog, Decan e Junik.

Pejë, më: 18.06.2024

Me respekt;
Zyra për Media e KRU 'Hidrodrini' -Pejë

